

Lo Sportello Sicurezza di Biella, di cui fanno parte l'I.N.A.I.L., la D.P.L. e l'A.S.L. 12, nell'ambito delle iniziative tese a promuovere la cultura della salute e della sicurezza ha realizzato, questo opuscolo formativo per fornire un contributo nell'ambito dell'informazione dei lavoratori stranieri che operano in edilizia.

L'obiettivo del testo è di fornire un'informazione e formazione di base sulla tutela della salute e della sicurezza durante il lavoro, anche a quei lavoratori che, per ovvie ragioni linguistiche, hanno maggiori difficoltà a comprendere il significato delle indicazioni loro fornite.

*Il presente testo è stato tradotto in quattro lingue: Albanese, Arabo, Rumeno e Serbo-Croato. **Vietata la vendita.***

Si ringrazia il Dipartimento di Sanità Pubblica della città di Bologna per aver concesso, senza vincoli di copyright, la pubblicazione di alcuni disegni/immagini.

Il testo è stato redatto a cura di:

Daniele Ferro (Tecnico della prevenzione - S.Pre.S.A.L. - ASL 12 Biella)

Traduzione in Albanese a cura di:

Ramiz Lala

*Il coordinatore dello Sportello Sicurezza
(Francesco Piemontese)*

Treguesi i Indes

<i>Informimi dhe formimi i punetorve</i>	<i>faqe</i>	<i>3</i>
<i>Faktoret qe ndikojne ne parandalimin e aksidenetve</i>	<i>faqe</i>	<i>4</i>
<i>Dokumentat e sigurimit</i>	<i>faqe</i>	<i>7</i>
<i>Renia nga lart e objekteve ose e personave</i>	<i>faqe</i>	<i>9</i>
<i>Groposja</i>	<i>faqe</i>	<i>21</i>
<i>Mbrojta nga shkarkesat elektrike</i>	<i>faqe</i>	<i>23</i>
<i>Spostimi me krahe i ngarkesave</i>	<i>faqe</i>	<i>25</i>
<i>Mbrojtja nga preparatet kimike</i>	<i>faqe</i>	<i>28</i>
<i>Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet</i>	<i>faqe</i>	<i>32</i>
<i>Perdorimi i makinave dhe pajisjeve</i>	<i>faqe</i>	<i>34</i>
<i>Mjetet personale mbrojtese</i>	<i>faqe</i>	<i>50</i>
<i>Sherbimet mjeksore e te ndihmes ne kantiere</i>	<i>faqe</i>	<i>65</i>
<i>Shenjat ne kantieret</i>	<i>faqe</i>	<i>66</i>
<i>Fjalor</i>	<i>faqe</i>	<i>72</i>

INFORMIMI

Punedhësi merr të gjitha masat në mënyrë që çdo punëtorë të marrë **informacionet** e duhura lidhur me:

- a) rreziqet për jetën dhe shëndetin e lidhura aktivitetin e ndërmarrjes në përgjithësi;
- b) masat dhe veprimet mbrojtëse që duhet të kryhen për të parandaluar aksidentet;
- c) rreziqet e veçanta që lidhen me aktivitetin që kryhet, rregullat e sigurimit dhe udhëzimet e ndërmarrjes në këto fushë;
- d) rreziqet që lidhen me përdorimin e lendeve të rrezikshme bazuar në skedën e të dhenave të sigurisë të parashikuara nga normativat në fuqi e normat e një teknike bashkëkohore
- e) procedurat e ndihmes së shpejtë, mbrojtja kundër zjarrit, largimi nga vendi i punës;
- f) përgjegjësinë e sigurimit teknik si dhe mjekun kopetent;
- g) emrat e punëtorëve të ngarkuar për dënimin e ndihmes së parë, ose për mbrojtjen nga zjarri e largimin nga vendi i punës në rastë rreziku.

FORMIMI

Punedhësi merr masat gjithashtu që çdo punëtorë, të marrë një **formim** të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm lidhur me sigurimin dhe shëndetin, e në veçanti lidhur me vendin e punës të secilit dhe me detyrat që duhet të kryejë.

Formimi duhet të bëhet me rastin :

- a) e marrjes në punë (punësimit)
- b) transferimit ose ndërrimit të detyrave (vendit të punës);
- c) kur hyjnë pajisje e teknologji të reja, lende e preparate të rrezikshme.

Formimi duhet të realizohet në mënyrë periodike në varesi të evolucionit të rreziqeve, ose me saktë, kur lindin rreziqe të reja.

Një formim i veçantë duhet t'u jepet personelit të ngarkuar me detyrën e zjarrefikimit, e largimit të punëtorëve nga vendi i punës në rast të një rreziku të rëndë e të befasishtëm, skuadrave të shpëtimin, të ndihmes së parë, me një fjalë të atyre që merren me situatat urgjente.

Formimi duhet të realizohet brenda orarit të punës dhe nuk duhet të sjellë kurrfarë shpenzimesh për punëtorët.

Punedhensit duhet te :

- vleresojne rreziqet qe lidhen:
 - me aktivitetin qe zhvillohet,
 - me impiantet, me mjetet e punes, makinerite, substancat dhe preparatet e rrezikshme qe perdoren
 - me menytrat praktike dhe me organizimin e punes.
- Te marrin masa per parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet, ne vecanti:
 - organizojne punen ne menyre qe te kete siguri
 - pajisin punetoret me makineri dhe mjetet te pershtatshme e te sigurta
 - pajisin punetoret me mjetet individuale e kolektive mbrojtese
 - informojne dhedhe kujdesen per formimin e punetoreve lidhur me detyren qe do te kryejne dhe rreziqet gjate kryerjes se saj
 - garantojne mbikqyrjen shendetsore te punetoreve

Pergjegjesi i kantierit, drejtori teknik (i caktuar per sigurimin ne kantier)

- veshkon dhe mbikqyr te gjitha punet, ne menyre te tille qe secila prej tyre te zhvillohet ne siguri te plote:
 - mbikqyr zhvillimin e punimeve
 - informon punetoret per rreziqet qe ekzistojne ne pergjithesi ne kantier dhe ne vecanti ne vendin e punes se sejcilit
 - terheq vemendjen punetoreve, qe te veshkojne procedurat e sigurimit gjate punes dhe te perdorin mjetet e pershtatshme per mbrojtjen individuale.
 - Jep punen ne perputhje me pergatitjen dhe aftesine e secilit punetore per ta zhvilluar ate.

punetori

- gjate punes çdo punetore duhet te kujdeset per sigurine dhe shendetin e tij dhe te personave te tjere te pranishem ne vendin e punes, te cilet mund te rrezikohen prej gabimeve o abuzimeve te tij qe lidhen ngushtesisht me formimin, me udhezimet e mjetet qe punedhensit i ve ne dispozicion dhe me tej:
 - te perdore si duhet makinerite, mjetet, impiantet, substancat kimike, duke patur parasysh udhezimet e punedhensit
 - te perdore me kujdes e me korrektesi mjetet e sigurimit, si kolektive ashtu edhe ato individuale te siguruar nga punedhensit
 - te lajmeroje menjehere punedhensin pergjegjesin e sigurimit teknik per demtimin ose keqfunksionimin e mjeteve te sigurimit, te mjeteve te punes, duke sinjalizuar gjithashtu se mund te paraqiten situata rreziku
 - te mos levizin, modifikojne, mjetet e sigurise dhe mjetet per mbrojtjen kolektive dhe individuale
 - te mos ndermarrin me iniciativen e tyre veprime qe nuk u jane caktuar atyre personalisht, e qe mund te rrezikojne sigurine e tyre dhe te punetoreve te tjere
 - t'u nenshtrohen kontrolleve shendetsore te parashikuara.

Pergjegjesi i sigurimit teknik

Pergjegjesi i sigurimit teknik eshte ai person qe(i emeruar) kryen rolin e kordinatorit deri ne perfundimin e punes ne kantier, nga te gjitha ndermarrjet zbatuese e nga punetoret autonome, ne perputhje me normat e higjenes e te sigurimit ne pune. Eksistojne dy aspekte te figures se pergjegjesit te sigurimit teknik: kordinator per sigurine ne fazen e projektimit te vepres (CSP) dhe kordinator per sigurimin ne fazen e zhvillimit te punimeve (CSE).

- Kordinatori per sigurimin ne fazen e projektimit te vepres eshte ai qe harton Planin e Sigurimit dhe Kordinimit
- Kordinatori per sigurimin ne fazen e realizimit te punimeve eshte ai qe :
 - verifikon, kontrollon dhe koordinon zbatimin e udhizeve ne lidhje me higjenen dhe sigurimin ne pune te perfshira ne Planin e Sigurimit dhe Kordinimit, nga ana e ndermarrjes qe realizon vepren dhe e punetoreve autonome.
 - Kontrollon dhe verifikon Planet Operative te Sigurimit te paraqitura nga ndermarrja
 - Organizon, mes pundeve dhe punetoreve nje bashkepunim dhe shkembim te informacionesh te nevojshme per sigurimin ne kantier, e gjithashtu mes anetareve te keshillit te sigurimit teknik
 - Nderpret punimet ne raste rreziku te larte e te befasishem

Te ngarkuarit per situatat e papritura (*parandalim i zjarrit, largimin e punetoreve dhe ndihmen te shpejte*)

Jane punetoret e caktuar nga punedhenesi, te cilet kane marre nje formim te pershtatshem e te veçante per te kryer funksionin e zjarrfiksesit, per te larguar punetoret nga ambienti i punes dhe per te dhene ndihmen e shpejte. Keta punetore kane si detyre te nderhyjne: ne raste zjarri sipas procedurave te mbrojtjes kunder zjarrit; ne raste rreziku te pergjithshem, te aktivizojne largimin e punetoreve qe gjenden ne kantier; ne raste aksidentesh o demtimi te organizojne dhenien e ndihmes se shpejte.

Pergjegjesi i Sherbimit per Parandalimin dhe Mbrojtjen nga rreziqet (RSPP)

RSPP qe duhet te ekzistojne ne çdo ndermarrje, eshte person i caktuar nga punedhenesi (ose vete punedhenesi), me njohuri dhe kompetenca mbi higjenen dhe sigurine ne pune, e duhet te marre masa per:

- percaktimin dhe vleresimin e rreziqeve
- percaktimin e masave per nderhyrjen dhe mbrojtjen nga rreziqet si dhe permiresimin e procedurave te sigurimit
- propozon programin per informimin e formimin e punetoreve
- informon punetoret lidhur me rreziqet dhe masat e sigurise qe jane pershtatur ne kantier si dhe si duhet te sillen ato.

Perfaqesuesi i punetoreve per sigurimin (RLS)

RLS eshte personi i zgjedhur nga vete punetoret dhe kryen detyren e perfaqesimit te vete punetoreve ne lenden e sigurimit ne pune. Mund te zgjidhet mes punetoreve qe punojne ne ndermarrje ose, nese kjo e fundit ka me pak se 15 punetore, mund te zgjidhet mes atyre qe bejne pjese ne sindikata, te quajtur RLST (RLS,perfaqesues te puntorve sindikaliste per territorin). Ne cilesine e perfaqesuesit te punetoreve RLS-ja:

- hyn ne vendet e punes
- konsultohet paraprakisht per vleresimin e rreziqeve, ne fazen e individualizimit, programimit, aplikimit e verifikimit te masave per parandalimin e tyre dhe mbrojtjen e punetoreve ne pune
- i merret mendimi lidhur me emrimin e te ngarkuarve per situatat urgjente, te zjarrfikeseve e te ndihmes se shpejte
- jep mendimin e tij lidhur me procedurat e formimit te punetoreve
- merr informacione dhe njihet me dokumentacionin ne lidhje me vleresimin e rreziqeve dhe masat e sigurimit, per materialet dhe perberjet e rrezikshme, per makinerite dhe pajisjet, per organizimin e punes, per aksidentet dhe semundjet qe lidhen me punen
- duhet te kete ne dispozicion kopjen e Planit te Sigurimit dhe Kordinimit dhe te Planit operativ te sigurimit te ndermarrjes te pakten dhjete dite perpara fillimit te punimeve
- mund te bej propozime ne lidhje me sigurimin dhe te ndermarre masa te pershtateshme lidhur me parandalimin e mbrojtjen prej rreziqeve
- paralajmeron punedhenesin dhe te ngarkuarit per sigurimin mbi rreziqet e konstatuara gjate punes.

Mjeku i ndermarrjes

Mjeku i ndermarrjes eshte mjeku qe ngarkohet nga punedhenesi per te mbikqyrur nga ana shendetesore punetoret dhe duhet:

- te njohe gjendjen shendetesore te punetoreve dhe te shprehe gjykimin e tij per nivelin e aftesise per pune
- hapjen dhe plotesimin ne vazhdimsi te karteles shendetesore
- per secilin punetore.
- te informoje punetoret mbi arsyet e kontroleve shendetesore te cilave u jane nenshtruar
- te informoje punetore e interesuar per rezultatet e kontrollit shendetesor
- te vizitoje ambientet e punes dhe kantieret per te shprehur mendime kompetente mbi gjendjen e ture.

*Mbikqyrja shendetesore parashikon nje vizite mjekesore paraprake (ne momentin e marrjes ne pune) dhe vizita mjekesore peridike. Punetoret duhet ti nenshtrohen mbikqyrjes shendetesore kur u ekspozohhen rreziqeve te tilla si: **zhurmave dhe lekundjeve, ekspozimi ndaj amiantit, ekspozim ndaj produkteve kimike dhe preparateve te rrezikshme, ekspozim ndaj agjenteve kancerogjen; ekspozim ndaj agjenteve biologjik; levizje me krahe e ngarkesave.***

Plani i sigurimit dhe koordinimit (PSK)

PSK-ja është ai dokument i redaktuar nga pergjegjesi per sigurimin dhe kordinimin ne fazen e projektimit qe permban: konstatimin, vleresimin dhe pasojat rreziqeve, si dhe procedurat e punes, te ngarkuarit per sigurimin, pajisjet te tilla, qe te garantojne gjate gjithë kohezgjatjes se punimeve respektimin e rregullave per parandalimin e demtimeve, e qe garantojne jeten e shendetin e puntorve, si dhe listen lidhur me shpenzimet per sigurimin.

Plani operativ i sigurimit (POS)

POS është nje dokument i redaktuar nga drejtuesi i ndermarrjes qe ndjek punimet ne çdo kantier, qe i referohet nje kantieri ne veçanti dhe duhet te permbaje veç tjerash:

- veprimtarine ne pergjithesi dhe punimet e veçanta te kryhen ne kantier nga punetoret ndermarrjes dhe nga mjeshttrat (artizan)
- emrat e personave te ngarkuar per ndihmen e shpejte, kunder zjarrit dhe largimin e punetoreve me sakte, per perballimin e rasteve urgjente ne kantier, te perfaqesuesit te punetoreve per sigurimin i ndermarrjes ose territorit, i zgjedhur ose i emruar;
- Emrat e drejtorit teknik dhe te drejtuesit te kantierit;
- Numrin e punetoreve dhe specializimet perkatese te ndermarrjes zbatuese dhe te mjeshtrove qe punojne per llogari te se njejtes ndermarrje;
- Detyrat e veçanta, ne fushen e sigurimit, te kryera ne kantier nga çdo person i emeruar posaqerisht nga ndermarrja zbatuese;
- Pershkrimin e veprimtarise se kantierit, te metodave organizative dhe te turneve te punes;
- Lista e armaturave, te urave e te veprave te tjera te perkoheshme te nje rendesie te vecante, te makinerive e te pajisjeve qe perdoren ne kantier;
- Lista e substancave dhe preparateve te rrezikshme qe perdoren ne kantier me skadat perkatese te sigurimit;
- Konkluzionet mbi vleresimin e nivelit te zhurmave;
- Percaktimin i masave parandaluese dhe mbrojtese ne lidhje me rreziqet qe mund te shkaktojne vete punimet ne kantier;
- Lista e pajisjeve mbrojtese individuale qe u jane dhene punetoreve qe punojne ne kantier;
- dokumentacionin persa i perket informacionit dhene punetoreve dhe punes per formimin etyre.

Punimet dhe veprimtarite ne kantier, i vene puntoret perballe rreziqeve per shendetin e sigurine, nganjehere edhe te renda. Mes tyre me te theksuar e te shpeshte veçojme


- ✓ *renia nga lart e personave dhe sendeve*
- ✓ *shembjet (rrezimi ose renia e pigrjeve gjate germimeve)*
- ✓ *goditja elektrike (kontakti direkt ose indirekt me linjat e tensionit)*
- ✓ *levizja me krahe e ngarkesave*
- ✓ *ekspozimi ndaj lendeve kimike ose substancave e preparateve te rrezikshme*
- ✓ *ekspozimi ndaj zhurmave e lekundjeve*
- ✓ *perdorimi i makinerive dhe pajisjeve*

Rreziku i renies nga lart shfaqet sa here qe punohet ne lartesi; ne çati, ne ballkone e mbi skela. Per te garantuar sigurimin e punetoreve qe punojne ne lartesi mbi 2 m, eshte e nevojshme te realizohen vepra te pershtatshme te perkoheshme mbrojtese. Nuk duhet harruar qe dhe disnivelet mbi 50 cm duhet te jene te mbrojtur ne menyre te pershtatshme, me qellim qe te evitohen rrezimet.


Skela metalike eshte nje mjet pune, nje veper e perkohshme, shume e perhapur ne ndertim, dhe kur vendoset ne menyre korrekte, garanton nje mbrojtje te mire kunder renieve nga lart. Skelat metalike duhet te jene te shoqeruara me nje autorizim te posaçem te zyres teknike.

Para se te vihen ne perdorim, elementet e skeles duhen kontrolluar qe te mos kene pesuar thyerje, shtremberime, plasaritje.


Gjate montimit dhe zmontimit te skeles, te vihen gjithmone rripat e sigurimit. Montimi dhe smontimi i skeles duhet te kryhet nga persona ekspert e nen mbikqyrjen e nje pergjegjesi, dhe duhet shoqerohet me nje program te pergatitur montimi e zmontimi. Skela duhet te jete pergatitur ne te gjitha pjeset e saj dhe eshte e keshillueshme te fiksohet ne pjeset e qendrueshme te nderteses ne ndertim ose rindertim.




Vendosja korrekte e skeles eshte garanci per sigurimin e punetoreve gjate punes:



Kembet duhet te mbeshteten ne toke duke perdorur bazament (kembezat). Duhet te realizohet rrafshi horizontal i mbeshtetjes: ne rastin e nje plani mbeshtetje ne disnivel, te mos perdoren materiale te rastesishme dhe te papershtatshme (si tulla), por bazat te parashikuara qe jane te rregullueshme. Nese terreni duket i pa qendrueshem, keshillohet te perdoren derrasa si bazament per shperndarjen e peshes.




Pasi eshte ndertuar kati i pare mbi te cilin levizin punetoret, eshte e detyrueshme vendosja e mbrojtjes anesore (parrmake) me te gjitha elementet e parashikuar, para se te nise pergatitja e katit tjetere. Qe nga fillimi per montimin e katit te pare e deri ne montimin e plote te skeles, eshte e detyrueshme te vihen rripat e sigurimit, detyrimisht te lidhura me elementet me te qendrueshme te vete skeles.



Para se skela te perdoret per te punuar te sigurohemi qe:



- plani ku do te levizett te jete i realizuar me trare metalike ose me derrasa per ure te nje trashesie prej 5 cm;
- derrasat e perdorura te jene te forta e te pa demtuara; te puthitura mire njera me tjetren dhe ne skaje te mbeshteten mbi njera- tjetren te pakten 40 cm;
- te kene mbrojtje te pershtatshme anesore



Mbrojtja anash duhet te perbehet prej nje derrase te gjere te pakten 20 cm, mbajtesja e kembeve, nga nje parmac i siperm i vendosur ne lartesine 1 m lidhur me bazamentin dhe nje tjetere parmac ne mes; qe te dy paralel me bazamentin.

Hapesira ne mes mbajteses se kembeve dhe parmakeve, nuk duhet t'i kaloje 60 cm (shih figuren A). Mbrojtja anesore duhet te realizohet edhe ne dy skajet e skeles.

Fig. A



Ne cdo 20 meter katror eshte e nevojshme te lidhet skela me pjeset me te qendrueshme te vepres ne ndertim. Keto lidhje nuk duhet te realizohen me mjete te rastit e te pa pershtatshme (litare, tela te perthyer) por me mjete te keshilluara nga ndertuesi, pergjithsisht me fiksues (tasselli) (fig. B), tuba e bashkues metalike (fig. C) ose materiale te ketij lloji.

Fig. B







Fig. C







Largësia nga bazamenti (skela) tek muri i ndertesës, nuk duhet të kalojë 20 cm, në të kundërt duhet të ngrihet mbrojtja anësore (pirmake) edhe në pjesën e brendshme të skeles, ose të vihen derrasa shtese për të mbyllur hapsirën.




Në katin e poshtëm të skeles duhet të ndërtohet një nënurë e sigurisë, e ndërtuar njëjellojë si ajo e shërbimit, me mbrojtësen të kembet, me parmaket anash dhe bazen mbi të cilën punëtorët livizin, gjithçka sipas rregullit. Nënura mund të mos bëhet kur punimet zgjasin më pak se 5 ditë. Për çdo përgjegjësi që vihet re në skele, duhet të njohet përgjegjësi i kantiarit.




Ndertimi i skelave mbi rrota behet duke ndjekur udhezimet e ndertuesit (teknikut) e duke realizuar te gjithë elementet e skeles, si bazamentin, mbajtesen e kembeve, parmaket dhe shkallet per t'u ngjitur neper kate. Nuk lejohet qe punetoret, per tu ngjitur, te kacavirren ne skele, por te perdoren shkallet.




Te mos spostohet skelen mbi rrota, kur ka punetore mbi te. Para se me u ngjite ne skele te behet frenimi i saj, dhe te vendosen ne toke elementet fiksues per te parandaluar levizjet e pa dëshirueshme.




Edhe ne raste pune qe zgjat per nje kohe te shkurter, per ndertimin e skeles, te mos perdoren mjete te rastit. Ngritesit telekomanduar, si rregull perdoren per nje kohe te shkurter. Jane te pajisur me kafazin e mbyllur ose me parmaket me lartesi 1m. Para se te behet ngjitja, mbyllet porta e hyrjes, kafazi duhet te jete i mbyllur. Gjate punes me ngritesit telekomanduar, kur ndodhemi ne lartesi, eshte mire qe punetori te jete i lidhur me rripat e sigurimit.




Kur punohet ne partesi, e per arsye teknike nuk eshte e mundur te ndertohet skela, duhet sidoqofte te ndertohen parmaket te cilat nuk lejojne te rrezohet punetori nga lartesite. Parmaket, si ai i kembes, i sipermi dhe i ndermjetmi, mund te jene prej druri ose prej tubash metalike te lidhur me bashkues.




Kur ekziston rreziku i renies nga lart dhe nuk jane vendosur skelat, duhet te vene gjithmone rripat e sigurimit, te cilat jane te pajisura ne amortizatore, me litare mbajtes, te cilet ne njerin skaj jane te lidhur ne pjese te qendrueshme te nderteses.




Ne pergjithesi rripat e sigurimit perdoren kur puna zgjat per pak kohe, ne rast mirmbajtje te çatise , mbuleses dhe te kanaleve anesore.







Rripat e sigurimit duhet të mbahen lidhura e të fiksohen fort në pjesët e me të qendrueshme të ndërtesës, edhe kur behen nderhyrje të thjeshta si montim, mirmbajtjen e oxhaqeve dhe antenave televizive.




Rripat e sigurimit përdoren edhe për riparime të vogla të çatise. Te mos lidhet litari me oxhakun apo pjesë të tjera të forta të çatise, por të vendoset një kavo e posaçme e lidhur dhe e vendosur mirë.




Te vihen rripat e sigurimit edhe gjatë vendosjes së parafabrikateve. Te lidhet mirë litari me pjesët e me të qendrueshme të ndërtesës.




Edhe perdorimi i shkalles se dores, sjell rrezikun e rënies nga lart. Te vendoset shkalla ne menyre korrekte. Te vendoset shkalla me pjerrtesi te pershtatshme; kendi i vendosjes duhet te jete rreth 75°.




Skaji i siperm i shkalles duhet te dale te pakten 1m mbi rrafshin ku duam te ngjitemi; te fiksohet shkalla mire edhe ne pjesen e sipërme




Kembet e shkalleve duhet te pajisen me taban jo rreshqites, dhe duhet te fiksohen ne shesh; nese kjo nuk eshte e mundur, duhet te mbahen nga nje person poshte.




Parmake te sigurte duhet te vihen per te rrethuar pjese te hapura te cratise, te hapesires se shkalleve, te tavanit, te ashensorit te koridorit, te portave, te cilat çojne ne hapesira boshe, ne ballkone. Edhe vrimat ne tavan, te cilat perdoren per shkarkimin e materialeve, duhet te jene te pajisura me parmake, dhe materiali duhet te hidhet ne toke me pajisje te pershtatshme, per te mos shaktuar rezik gjate renies nga siper.



Gjate prishjeve me krahe, kur nuk jane vendosur skelat, te vihen rripat e sigurimit: Te behet prishja duke patur parasysh udhezimet e dhena nga punedhenesi, pergjegjisi i kantierit, sidoqofte parafabrikati te priset pjese pjese. Te mos hidhen copat poshte, por te behet ulja e tyre me mjete te pershtatshme.




Edhe gjate ngjitjes se materialeve me krik elektrik, ekziston rreziku i renies poshte te ketyre materialeve apo i personave. Vendorsja e krikut ose e rrotullës, te behet duke ndjekur udhezimet e teknikut




Gjate ngjitjes se materileve me krik, vinç o pajisje tjeter, punitori te mos qendroje per gjate rrezes se veprimit te mjetit ngrites. Sidoqofte te vihjet gjithmone kasketa.

Rreziku nga shembjet (rrezimi apo spostimi i dheut)


Germimet, qofte kur behen me krahe, qofte me makineri, duhet te kene nje pjerrresi ne pershtatje me perberjen e terrenit qe te menjanoje rreshqitjet




Nese per vete perberjen e terrenit, prej shiut, per shkak te ujerave nentokesore, prej ngrirjes se ujit e shkrirjes se akullit, dyshohet se mund te kete rreshqitje, duhet te behet armatura e pershtatshme per te mbajtur terrenin.



Gjate germimit te puseve, kanaleve apo transheve me te thella se 1.50m, e terreni nuk duket i forte e i qendrueshem, nevojitet te ndertohet armature mbajtese, per te vazhduar punimet.




Te mos perdoren armaturat per t'u ngjitur e per te zbritur. Te perdoret shkalla e fiksuar mire ne maje dhe qe nuk rreshqet.




Germimet duhet te jene te mbrojtura me parrake te pershtatshem, per te penguar rezimin. Kalimi i automjeteve ne afersi te germimit perben rrezik shembjeje ose renie materiali.


Kur germimet behen me mjete te mekanizuara, eshte e ndaluar te qendrohet brenda rrezes se veprimet te makinerise




Ne kantieret e ndertimit renia nen tension eshte nje rrezik qe ndodh jo rralle. Rrjeti elektrik, pjeset elektrike te pajisjeve qe perdoren, jane ne ndryshim te vazhdueshem. Kjo e shton mundesine qe te demtohen si: spina, priza, tela percjelles, butona komandimi etj.




Para se te perdoret pajisja elektrike te kontrollohen mire kablli, spina e butoni i komandimit nese jane demtuar: Prizat e spinat duhet te jene te tipit industrial dhe jo civil. Nese vihen re demtime, te lajmehet pergjegjesi i kantierit.



Edhe nje llambe e thjeshte, e levizshme mund te perbeje rrezik. Te sigurohemi qe llamba te kete kafazin mbrojtës dhe kablli te mos jete i zhveshur.



Pajisjet elektrike te levizshme jane objekte spostimesh te vazhdueshme, e per kete arsye mund te konsumohen e demtohen. Para se te perdoren, te kontrollohen mire.



Rreziku i prekjës së telave me elektricitet ekziston kur punohet në afërsi të tyre. Të mos punohet më afër se 5 m nga linjat elektrike ajrore.

Levizja me krahe e ngarkesave

Levizje me krahe te peshave kuptojme veprimin e ngritjes, trasportimit e mbajtjes se tyre. Levizja me krahe e peshave sjell demtime te shtylles kurrizore. Rreziku nuk lidhet vetem me faktin sa e rende eshte pesha (nuk duhet t'i kaloje 30 Kg), por edhe me menyren se si veprojmë gjate mbajtjes, trasportimit apo ngritjes se peshes..

Per kete arsye, duhet te zvoglojmë sa te jete e mundur peshen qe do te levizet, e kur eshte e mundur, te perdorim mjete ndihmese si karroce , karrel etj.

Nese kjo nuk eshte e mundur, duhet te njohim mire pozicionet korrekte gjate ketyre veprimeve, per te ruajtur shendetin.

Rreziku i plagosjes rritet kur:

- ngarkesa eshte e rende (*me si 30 Kg*)
- ngarkesa eshte e vellisshme, e veshtire per t'u kapur
- ngarkesa mund te levizet vetem duke e mbajtur larg trupit
- hapesira perreth eshte e ngushte
- levizja mund te kryhet vetem duke perdredhur belin
- duhet bere nje sforcim i pa zakonshem
- ngarkesa eshte jo e qendrueshme
- trupi eshte ne pozicion te pa qendrueshem
- terreni ku levizim eshte jo i rrafshete





Kur e ngrini thesin mos perkulni shpinen apo trupin, afrojuni sa me afer ngarkeses qe do te levizet.

Perkulni kembet, e kur eshte e mundur levizni thesin me ndihmen e nje punetori tjetet.

Mos e ngarkoni thesin ne sup ose ne shpine.



Vijeni ne menyre te tille, qe pesha te bie edhe mbi kembet dhe shpina te mbahet drejt.







Edhe kur ngrini tulla, mos perkulni shpinen por kembet dhe mbajeni trupin sa me afer ngarkeses qe do te levizni

Mos perdredhni tringun per te levizur nje ngarkese, por levizni pozicionin e kembave duke mbajtur drejt shpinen




Gjate mbulimit te çatave, mbajtja e mbuleses dhe vendosja e saj nuk duhet te behen duke perkulur shpinen, por kembet duke mbajtur sa me drejt shpinen.

Edhe ku ne pamje te pare, duket se nuk kemi te bejme me levizje ngarkesash, nuk duhet te merren pozicione qe rendojne shtyllen kurrizore, por te perdoren mjete ndihmese qe lehtesojne punen.



kur eshte e mundur te vendoset materiali qe perdoret ne nje fare lartesisie, per te zvogeluar perkuljen e shpines dhe te kembeve

edhe ne zgjedhjen e mjeteve ndihmese eshte mire te perdorenato qe zvogelojne sforcimet dhe shmangin perkuljet e panevojshme te shpines.



Ekspozimi ndaj substancave kimike preparateve te rrezikshem

Nje numer i madh produktesh e materialesh qe perdoren ne ndertim klasifikohen si te rrezikshme. çimento, ngjitese, ngurtesues, jane sikurse perbersit e tyre, te rrezikshem per shendetin (te demshem, o helmues, me efekt te menjehershem ose te ngadalshem) dhe sigurine (zjarr, shperthim, gerryerje) e personave qe i perdorin.

Kontakti, thithja, gellitja jane rruget nepermjet te cilave keto substanca behen te rrezikshme.



per t'u mbrojtur nga keto rreziqe, eshte e rendesishme qe keto substanca dhe agente kimike te perdoren ne menyre korrekte.



Etiketa ne kutite ku jane ambalazhuar o mbi mbeshtjelleset, permbajne informacione te rendesishme per figurine ne perdorimin e tyre.



Por jane **skadat** e **sigurise** qe shoqerojne produktin, te cilat permbajne informacione me te zgjeruara.

Para se te perdoret produkti ose substanca te shihet **etiketa** ne kutine ku eshte amballazhuar. Etiketa permban disa shenja te rendesishme, nder te cilat:

simbolet per sigurine, te cilat riprodhojne nje pamje me ngjyre te zeze ne sfond kafe, e cila jep nje ide lidhur me rrezikshmerine e produktit (*shih shembujt e meposhtem*)



Gerryes

C



i demshem (Xn)

shqetesues (Xi)

Xn / Xi



shperthyes

E



e djegshme

F+ / F



*ndihmon
djegjen*

O



helmues

T+ / T

- fjali rreziku (**R**), qe permbajne informazione mbi rrezikshmerine e produktit e qe pershkruajne shkurt rrezikun
- fjalite keshilluese (**S**), japin keshilla te nevojshme si te perdorim, manovrojme, magazinojme, ne menyre te sigurt substancat e rrezikshme.

<u>Shembuj: FJALI RREZIKU (R)</u>	<u>Shembuj FJALISH KESHILLUESE (S)</u>
R9 Shperthen ne rast perzierje me lende djegese	S3 Te ruhet ne ambiente te fresketa
R10 Lende e diegshme	S7 Te ruhet ne kuti te mbyllura mire
R20 Demton rruget e frymemarrjes	S8 Te ruhet nga lageshtia
R21 Demton ne kontaktin me lekuren	S9 Te ruhet ena ne vende te ajrosura
R22 E demshme ne rast se gelltitet	S12 Te mos mbyllet hermetikisht ena
R23 Helmuese ne rast se merret permes frymemarrjes	S15 Te ruhet larg nga burimet e nxehtesise
R24 Helmuese ne rast kontakti me lekuren	S16 Te ruhet larg nga flaka e nga shkendijat.
R25 Helmuese ne rast gelltitjeje	Ndalohet duhani
R26 Shume helmuese ne rast se merret permes frymemarrjes	S17 Te ruhet larg lendeve te djeghme
R27 Shume helmuese nne rast kontakti me lekuren	S18 Te trajtohet e te hapet me kujdes
R28 Shume helmuese ne rast gelltitjeje	S20 Te mos hahet e pihet gjate perdorimit.
R34 Shkakton djegie	S21 Ndalohet duhani gjate perdorimit
R35 Shkakton djegie te rende	S22 Mos thith pluhurat
R36 Ngacmuese per syte	S23 Te mos thithet gazi/tymi/avujt
R37 Ngacmon rruget e frymemarrjes	S24 Te shmaget kontakti me lekuren
R38 Ngacmuese per lekuren	S25 Te shmaget kontakti me syte
R39 Rrezik demtimesh te renda qe mbeten	S27 Te hiqen menjehere nga trupi rrobat e infektuara
R40 Mund te shkaktoje kancer-prova te pa mjaftueshme	S28 Ne rast kontakti me lekuren te behet larja e menjehershme dhe e bollshme
R41 Demton rende syte	S36 Te perdoren veshje mbrojtese te pershtatshme
R42 Mund te demtoje ndjeshmerine <u>ndaj infeksioneve</u>	S37 Te perdoren doreza te pershtatshme
R43 Mund te demtoje ndjeshmerine e lekures ne kontakt me te	S38 Ne rast munngese te ajrimit normal te perdoren pajisje per ajrim
R45 Mund te shkaktoje kancer	S39 te ruhen syte dhe fytyra
R48 demton rende shendetin ne rast ekspozimi per nje kohe te gjate	S46 Ne rast gelltitjeje keshillohuni menjehere me mjekun duke i treguar etiketen ose enen mbajttese.
R68 Mund te shkaktoje deme te pa riparueshme per shendetin.	

Jo te gjitha produktet qe perdoren, kane etiketa si psh: gazi e avulli qe çlirohet gjate saldimit, apo pluhuri qe krijohet gjate sharrimit te drurit. Per kete arsye eshte e rendesishme te lexohet **skeda e sigurimit** e substances per te pasur te gjitha informacionet e nevojshme per tu mbrojtur nga rreziqet gjate perdorimit te tyre

Skeda e sigurimit (e perbere prej 16 pikash) permban informacione te rendesishme si:

- Emrin e substances
- Percaktimin e rrezikut
- Dhenien e ndihmes se pare
- Masat kunder zjarrit
- Trajtimin dhe magazinimin
- Masat qe duhen marre ne rast perhapjeje pa dashje
- Mbrojtja vetjake
- Veçorite kimike dhe fizike
- Informacione mbi vetite helmuese

Te ndiqen udhezimet e punedhenesit, te lexohen gjithmone informacionet qe permbahen ne skeden e sigurimit e te perdoret produkti ne perputhje me keshillat qe ajo jep, nese lypset te perdoren mjetet mbrojtese vetjake.

Disa aktivitete ndertimi, si p.sh. shembja e mureve, dhe shume makineri dhe pajisje qe perdoren ne kantier, i vene punetoret para rrezikut te ekspozimit ndaj zhurmave.

Ekspozimi i zgjatur ndaj nje zhurme me nivel me te larte se 85 decibbel (dBA), mund te sjelle shurdhim te pjesshem; zhurmat me nivel deri ne 140 Db(A) mund te shkaktojne shurdhim te plote dhe prishje te timpanit te veshit.

Edhe kur nuk perdoren mjete ose makineri qe bejne zhurme, mund te jesh i ekspozuar ndaj zhurmes, qe bejne mjete e makineri, qe perdoren nga punetore te tjere ne kantier.

Punedhenesi duhet te vleresoje nivelin e ekspozimit te punetoreve ndaj zhurmave dhe duhet te:

- *Per nivelin e ekspozimit ndaj zhurmave me te larta se 87 dB(A), te pajise punetoret me mbrojtese te pershtatshem per veshet (kufje ose tapa); ti informojeato per rrezikun, dhe te kujdeset per formimin dhe kontrollin mjekesor te tyre.*
- *Per nivelin e ekspozimit ndaj zhurmave mbi 87 dba eshte e detyrueshme te perdoren mjetet mbrojtese te pershtatshme per veshet dhe te behet kontrolli mjekesor.*




Punetori duhet te informohet mbi ekspozimin ndaj zhurmes me te cilen ka te beje dhe duhet:



- *per nivelin e ekspozimit ndaj zhurmave me te larta se 85 dB(A) : te perdore, edhe pse jo e detyrueshme, mjetet e pershtatshme mbrojtese per veshet (kufje ose tapa) me te cilat e ka pajisur punedhenesi dhe te behet kontrolli mjekesor.*
- *Per nivelin e ekspozimit ndaj zhurmave mbi 87 dB(A) eshte e detyrueshme te perdoren mjetet mbrojtese te pershtatshme per veshet dhe te behet kontrolli mjekesor.*

Ekspozimi ndaj lekundjeve mekanike gjate punes sjell rreziqe per shendetin e punetoreve.

Pajisje te tilla si eskavatori(germuesi), rruspa, lopata mekanike, tek personat qe i perdorin, shkaktrojne dridhje, qe perfshijne te gjithë trupin.



Te tjera pajisje si: guri zmeril, trapani, marteli pneumatik , tek personat qe i perdorin, shkaktrojne dridhje, qe perfshijne duart dhe krahet.

Punedhënesi duhet te vleresoje shkallen e ekspozimit ndaj rrezikut te dridhjeve dhe te marre masat e duhura per te pakesuar rrezikun:

- te perdore makineri qe shkaktrojne me pak dridhje
- te kufizojë kohezgjatjen dhe intensitetin e ekspozimit ndaj dridhjeve te realizojë periudha pushimi ne mes dy ekspozimeve ndaj dridhjeve
- te pajise punetoret me pajisje e mjete qe pakesojne rrezikun e plageve, p.sh. ndenjese qe amortizojne dridhjet qe arrijne ne trup, ose doreza qe zvogelojne dridhjet e duarve dhe te kraheve.
- te pajise punetoret me dorashka te pershtatshme per te pakesur dridhjet e duarve e te kraheve
- te pajise punetoret me nje formim te pershtatshem
- te vendose nen kujdesin mjekesore punetoret qe ekspozohen ndaj dridhjeve.

GURI ZMERIL



TE DHENA PER SIGURINE E ATYRE QE I PERDORIN

Analize e rrezikut

- ✓ prerje dhe gervishtje si pasoje e kontaktit me diskun rrotullues
- ✓ demtime dhe plage syve te shkaktuara nga krijimi i copave te gureve
- ✓ shkarkesa elektrike si pasoje e demtimit te kavos ushqyese dhe e kontaktit te diskut me impiantin teknologjik ne tension
- ✓ zhurme
- ✓ zjarr ose shperthim te sjelle nga shkendijat
- ✓ pluhur i krijuar gjate fazes se prerjes, zmerilimit, fshirjes dhe lemimit.

Tregues te pergjithshem te sigurimit

- * te kontrollohet disku nese eshte i pershtatshem per punen qe do te behet dhe nese eshte i montuar ne sensin e sakte te rrotullimit
- * eshte e ndaluar te kryhen prerje dhe zmerilime mbi bombola te mbyllura ose rezervuare qe permbajne ose permbanin gaz te djegshem, ose shperthyes, ose substanca te tjera qe jane ne gjendje te prodhojne avuj shperthyes.
- * Te verifikohet prania e materialeve qe marrin flake ose qe shperthejne ne afersi te vendit ku punohet.
- * Te kontrollohet nese disku eshte i pershtatshem per punen qe do kryhet
- * Te kontrollohet nese butonat dhe mjetet e komandimit, ndezjes dhe fikjes funksionojne mire
- * Te kontrollohet efikasiteti dhe vendosja korrekte e kufjeve mbrojtese ndaj ciflave dhe ne pergjithesi e mjeteve mbrojtese
- * Te kontrollohet gjendja e diskut perres.

Gjate perdorimit

- * te shmanget prania e personave te tjere afer vendit ku punohet.
- * te ndalohet qe punetore te tjere pa lajmeruar te aktivizojne impiante teknologjike ne zonen ku punohet (elektricitet, gas, uje, etj.)

- * Eshte e ndaluar te kryhen regjistrime, pastrime ose riparime te pajisjes nderkohe qe pajisja eshte ne funksionim e siper
- * Gjate ndalese per nje kohe te zgjatur, te hiqet spina ushqyese ose te mbyllet valvola e kompresorit

- * Te fiksohet mire objekti qe punohet, me ane te morsetave, duke evituar fiksimit e rastit, si per shembull: vendosja objekti nen kembe, ose mbajtja me duar ose me pinca.
- * Te shtrengohet pajisja me te dyja duart, per te garantuar qendrueshmeri te sigurte
- * Te mos ushtrohet force mbi materialin gjate lemimit, por te mbahet lirshem pajisja
- * Gjate fazes finale te prerjes ‘ti kushtohet vemendje e veçante kundergoditjeve te materialit qe punohet, ose copezave qe shkeputen (p.sh: gjate prerjes se hekurit etj.)
- * Te mos preken pjeset metalike te pajisjes gjate punes mbi dysHEME, mure, ose aty ku eshte e mundur te takohen kavo elektrike
- * Te mos preket disku menjehere pas procesit te zmerilimit ose prerjes, sepse mund te shkaktoje djegje
- * Te mos ndalohet disku ne levizje mbi objektin qe po punohet
- * Te sinjalizohen menjehere parregullsi gjate punes ose situata te rrezikshme




Gjate perdorimit te vishen keto MMI (DPI): *kaska , syzet ose mbrojtësja e fytyres; mbrojtësit e veshëve; tuta mbrojtëse; doreza; kepuce kunder demtimeve*

Ne perfundim te punes

- * te hiqet spina
- * te behet pastrimi dhe mirembajtja e pajisjes, duke mos e lene menjane te piste.
- * te kontrollohet nese gjate punes pajisja ka pesuar ndonje demtim.
- * para se te fillohet me mirembajtjen, te hiqen spinat dhe te stakohet rryma elektrike ose tubi i ajrit
- * para se te zevendesohet disku, te hiqet spina dhe te mbyllet ajri.
- * te vendoset pajisja ne nje vend te mbrojtur e pa lageshti

TRAPANI



TE DHENA PER SIGURINE E ATYRE QE I PERDORIN

Analize e rreziqeve

- goditje elektrike
- goditje, shtytje, shtypje, perplasje
- shpuarje, prerje, gervishtje
- pluhur
- zhurme

Tregues te pergjithshem per sigurimin

- * te perdoren veç mjete me izolim te dyfishte (220V), ose mjete te ushqyera me tension shume te ulet sigurimi (50V), sidoqofte te mos behen tokezime
- * te kontrollohet qe kavoja ushqyese te mos kete pesuar demtime
- * te kontrollohet qe kavoja elektrike te mos krijojë pengesa gjate punes
- * te kontrollohet funksionimi i çelesit te kontrollohet fiksimi i rregullte i majes shpuese dhe pjeseve te tjera
- * te kontrollohe qe vrimat e ftohjes dhe ventilatori te mos jene te bllokuara

Gjate perdorimit

- * te hiqet spina gjate nderprerjes te punes
- * te sigurohet qendrueshmeria e objektit gjate punimit te tij
- * te vazhdohen punimet ne kushte te qendrueshme
- * te perdoren maja shpuese (punto) sipas punes qe po kryhet



Gjate perdorimit te pajisjeve te vishen mjetet mbrojtese individuale te meposhtme (DPI): aspirator kuder pluhurit per fytyren; mbrojtes per veshet; doreza; kepuçet e sigurimit; syzet mbrojtese.

Ne perfundim te punes

- * te shkeputet korenti
- * te fiket kompresori i ajrit dhe te zbrazet rezervuari i ajrit
- * te shkeputet tubi i ajrit prej pajisjes
- * te mirmbahet pajisja sipas udhezimeve te prodhuesit

**Analize e rreziqeve**

- * *goditje, shtytje, shtypje, perplasje*
- * *ekspozimi ndaj zhurmes*
- * *ekspozim ndaj pluhurave*
